



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2823/ 7 prot.

Datë 03.11.2025

V E N D I M
Nr. 1576/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Gjergj Mersini	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 03.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar të ankesës së operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-60127-09-02-2025, me objekt “Rikonstrukcion i Shkollës “Mark Dashi”, Bashkia Fier” me fond limit 50 661 598.12 *(pesëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë dymbëdhjetë)* lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

Vazhdim i procedurës së shqyrtimit në themel për pjesën tjetër të ankesës së operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, në procedurën e prokurimit të sipërcituar.

Shfuqizimi i vendimit të autoritetit kontraktor për anulimin e procedurës së prokurimit të sipërcituar.

Ankimues:

OE “Shendelli” SHPK me NIPT K07924803N dhe me adresë Lagjja Kastrioti ,rruga Andon Profka ,2 kullat Fier, Fier.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Fier me adresë Lagja “Kastriot”, Rruga “Ramiz Aranitasi”, Nr.15, Fier

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga tre anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 03.09.2025, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, procedura e prokurimit “E hapur”, me Nr. **REF-60127-09-02-2025**, me objekt “Rikonstruksion i Shkollës “Mark Dashi”, Bashkia Fier” me fond limit **50 661 598.12 (pesëdhjetë milion e gjashtëqind e**

gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.

II.2. Në datën 18.09.2025, autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si dhe informacionit të operatorit ekonomik ankimues, rezulton, se në datën 06.10.2025, është bërë klasifikimi i operatorëve ekonomikë pjesëmarrës, duke i njoftuar me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të ofertave ekonomike për vlerat (pa TVSH), si më poshtë:

1. “MODESTE” shpk	34,078,870.10 lekë	Skualifikuar
2. “RSM Company” shpk	35,031,310 lekë	Skualifikuar
3. “AURORA KONSTRUKSION” shpk	37,841,093 lekë	Skualifikuar
4. BOE J O G I SHPK & ERAL CONSTRUCTION COMPANY Shpk & S P E K T R I SHPK	37,963,282.10 lekë	Skualifikuar
5. B.O.E ”SARDO” SHPK & LIQENI VII SHPK	37,997,607 lekë	Skualifikuar
6. O.E AVDULI SHPK	41,106,873 lekë	Skualifikuar
7. O.E DESARET COMPANY SHPK	41,934,079.58 lekë	Skualifikuar
8. O.E Shendelli SHPK	42,160,337 lekë	Skualifikuar
9. O.E INA SHPK	43,085,279 lekë	Skualifikuar
10. NGRACAN 1934 SHPK	0 lekë	Skualifikuar
11. FRONTIER CONSTRUCTION SHPK	0 lekë	Skualifikuar

II.4.Operatori ekonomik “Shendelli” SHPK rezulton i skualifikuar nga procedura e prokurimit me arsyet se: “ Referuar shtojces 3 “Formulari i Sigurimit të Ofertës” ne DST, rezultojne te paplotesuara paragrafet:

- Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

- Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-së

- Referuar shtojces 1 “Formulari i Ofertës Ekonomike”, ofertuesi duhet të shënojë në Formularin e Ofertës, çmimet totale të Ofertës për të gjithë zërat e preventivit pa TVSH. Vlera e TVSH-së, kur aplikohet, i shtohet çmimit të dhënë dhe përbën vlerën totale të Ofertës me TVSH.

Nga verifikimi i kryer në Sistemin e Prokurimeve Elektronike lidhur me oferten ekonomike dhe dokumentacionit teknikoligjor te praktikës se Njesise se Prokurimit, KVO konstaton se operatori ekonomik i mesiperm ka dorëzuar: Shtojcën 1 “Formularin e Ofertës” në të cilën është pasqyruar se vlera totale e ofertës ekonomike pa TVSH është 42,160,337 leke. Ndersa vlera totale e ofertës ekonomike me TVSH është 50,592,405 leke.

Gjatë llogaritjes së preventivit sipas shojces 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, ne zërin “Pajisje jashte liste”: “Fikse zjarri 6 kg ABC” vjen ne vleren e ofertuar 90000 leke pa TVSH dhe ne vleren totale te ketij preventivi i shtohet përsëri TVSH.

Për sa më lart, punimet: Instalim IT, elektrike, sistemi i ngrohjes dhe punimet ne preventivin MNZ, pervec zerit: “pajisje jashte liste”, janë pjesë e shpenzimeve të drejtëpërdrejta të cilave u shtohet vlera e TVSH-së në fund të preventivit, ndërsa vlera e pajisjeve vendoset në fund të preventivit pas vlerës së TVSH-së, dhe nuk tatohen me TVSH.

Ne zbatim te ligjit nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, neni 53 “Perjashtime per disa veprimtari te tjera”, jane furnizime te perjashtuara nga TVSH, transaksionet e meposhtme: g.) furnizimi i ndertesave apo i pjeseve te nje ndertese, si edhe furnizimi i tokes, ne te cilen qendron ndertesa, pervec furnizimit te procesit te ndertimit”, si dhe Udhëzimit nr.6 datë 30.01.2015 të Ministrisë të Financave “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në RSH, keto pajisje nuk tatohen me TVSH.

Për sa kohë që pajisjet e mësipërme të parashikuara në preventivin e autoritetit kontraktor e kane TVSH (per pajisje) 0.00 leke, atëherë në ofertën ekonomike përfundimtare (totale), vlera totale e ketyre pajisjeve do të shtohet në përfundim të totalit të propozuar të ofertës ekonomike me TVSH, pa u tatuar perseri me TVSH. Përlllogaritja e ofertës ekonomike në kundërshtim me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi përbëjnë shkak për skualifikim.”.

II.5. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 07.10.2025 është publikuar “Njoftimi i Anilimit” të procedurës së mësipërme të prokurimit, publikuar edhe në Buletin e Njoftimeve Publike me nr. 58, datë 13.10.2025.

II.6. Në datën 13.10.2025 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2823/2025 protokolli, datë 13.10.2025 dhe me numër ankimi elektronik A/2025/5929 e OE “Shendelli” SHPK. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua, se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së paraqitur prej tij në procedurën e prokurimit objekt ankimi.

II.7. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 2823/1 prot., datë 14.10.2025.

II.8. Nëpërmjet sistemit elektronik, autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 9790/16 prot., datë 16.10.2025, protokolluar me tonen me nr.2823/2 prot., datë 16.10.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të prokurimit Publik informacion mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe aktin e trajtimit të ankesës, vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nr.9790/15

prot., datë 15.10.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, në të cilin është vendosur pranim i pjesshëm.

II.9. Nëpërmjet shërbimit postar, autoriteti kontraktor me shkresën me nr. 9790/16 prot., datë 16.10.2025, protokolluar me tonen me nr.2823/2 prot., datë 16.10.2025, ka përcjellë pranë Komisionit të prokurimit Publik informacion mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi, si dhe aktin e trajtimit të ankesës, vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesave (KSHA) nr.9790/15 prot., datë 15.10.2025, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK, në të cilin është vendosur pranim i pjesshëm.

II.10. Me shkresën me nr. 11943 prot., datë 24.10.2025, protokolluar me tonën me nr. 2823/4 prot., datë 27.10.2025, autoriteti kontraktor, ka paraqitur një kërkesë për përshpetim trajtimi të ankesës.

II.11. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ, nuk rezulton të jenë paraqitur argumente nga subjekte të interesuara, në kuptim të nenit 113, të ligjit 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK, mbi kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e tij, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Nëpërmjet shkresës me nr. 9790/16 prot., datë 16.10.2025, protokolluar me tonen me nr.2823/2 prot., datë 16.10.2025 ka vënë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, lidhur me vlerësimin e ankesës së paraqitur nga OE “Shendelli” SHPK, për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor e **ka pranuar pjesërisht**, ankesën Konkretisht, autoriteti kontraktor në vendimin e sipërcituar ka arsyetuar si më poshtë:

Komisioni I Shqyrtimit të ankesave **vlerëson se:** Nga shqyrtimi i të gjithë dokumentave të vëna në dispozicion nga dokumentacioni fizik i dosjes së kësaj procedure prokurimi publik, verifikimeve të dokumentave të hedhura në sistem (S.P.E.) për zhvillimin e kësaj procedure, rezulton se në SPE nga Njësia e Prokurimit Publik i Autoritetit Kontraktor, Bashkia Fier janë ngarkuar të gjithë dokumentat ligjor, kriteret e pjesëmarrjes, vlerësimit, Dokumentacionet Standarte të Tenderit, procesverbali I argumentit të kritereve, specifikimet teknike në zbatim të legjislacionit dhe rregullave të prokurimit publik., si dhe shtojca 3 . “Formulari i Sigurimit të Ofertës.

Nga operatori ekonomik **O.E “SHENDELLI” Sh.p.k** rezulton se në plotësim të kësaj kërkesë është ngarkuar në SPE Formulari i Sigurimit të Ofertës nga kompania e sigurimit EUROSIG , FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS Nr.serial 060140380059240 , Datë : 18.09.2025 , lëshuar në Fier , më 17/09/2025 , ku është bërë përshkrimi i shkurtër i kontratës “ Rikonstruksioni i Shkollës “ Mark Dashi” , Bashkia fier , ku vërtetohet se nga shoqëria “SHENDELLI” Sh.p.k ka derdhur një depozitë pranë shoqërisë së sigurimit “Eurosig “ SH.A vlerën prej 1,013,231.96 (një milion e trembëdhjetë mijë e dyqind e tridhjetë e një presje nëntëdhjetë e gjashtë) lekë , ku marrin përsipër të transferojnë në llogarinë e Bashkisë Fier depozitim për llogari të Bashkisë Fier , brenda 15 (pesëmbëdhjetë) nga kërkesa

Në formularin e sigurimit të ofertës është përcaktuar dhe periudha e vlefshmërisë për periudhën e specifikuar 150 ditë . Formulari i Sigurimit të Ofertës është i ngarkuar në SPE i nënshkruar dhe vulosur nga Kompania e Sigurimit EUROSIG SH.A .

Pra në vlerësim sa më lart KSHA vlerëson se dokumentacioni i paraqitur në SPE nga O.E “SHENDELLI” Sh.p.k Formulari i sigurimit të Ofertës ditëve është ngarkuar në SPE .

Bazuar në nenin 83 të Ligjit Nr.162/2020 i ndryshuar , nenin 30 , pika 2, 3 “ Sigurimi i ofertës “ , i VKM -së nr.285, datë , date19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” , i ndryshuar Autoriteti kontraktorkërkon paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël, sikurse përcaktohet në nenin 83, të LPP-së , si kërkesë ligjore për garantimin e zbatimit të kontratës , objekt prokurimi , duke specifikuar sipas DST-së ,

KSHA vlerëson se dokumentacioni i ngarkuar në SPE , në përmbushje të kërkesës së Autoritetit Kontraktor , për sigurimin e ofertës , Formulari i sigurimit të ofertës nga O.E “SHENDELLI” Sh.p.k i përmbush kërkesat e vlefshërisë ligjore.

III.1.2. Neni 30 i LPP parashikon shprehimisht se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera”.

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 2 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se : “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e

autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/ pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

2. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon pjesërisht ankesën dhe nuk ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, Komisioni i Prokurimit Publik, brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes për pjesën e pranuar dhe vazhdon procedurën për pjesën tjetër.

III.1.4. Për sa më sipër citur, bazuar në nenin 115 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, do të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar dhe do të vazhdojë shqyrtimin për pjesën tjetër të ankesës për procedurën e prokurimit objekt – ankimi.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK, mbi kundërshtimin e skualifikimin të ofertës së tij me arsyet: “Gjatë llogaritjes së preventivit sipas shojces 2 “Lista e çmimeve sipas zërave të preventivit”, ne zërin ”Pajisje jashte liste”: “Fikse zjarri 6 kg ABC” vjen ne vleren e ofertuar 90000 leke pa TVSH dhe ne vleren totale te ketij preventivi i shtohet përsëri TVSH”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përgjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, nisur nga arsyeja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me vendimet dhe veprimet e ndërmarra kryesisht nga autoritetit kontraktor gjatë zbatimit të hapave të mëtejshëm të procedurës së prokurimit objekt-ankimi.

III.2.2. Marrë shkas nga arsyetja e skualifikimit të operatorit ekonomik ankimues “Shendelli” SHPK, nga verifikimi i strukturës së preventivit të përcaktuar nga autoriteti kontraktor, në bazë të të cilit është bërë më pas edhe shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertës, Komisioni i Prokurimit Publik, konstaton, se ky preventiv është hartuar në kundërshtim me legjislacionin në fuqi, pasi shkakton konfuzion e paqartësi në mënyrën e përmbushjes së tij, si dhe në vlerësimin e ofertave, konkretisht vëren se:

III.2.3. Autoritetit kontraktor ka ngarkuar në sistemin elektronik të prokurimit në rubrikën “Dokumentat e tenderit” preventiv pa cmime me përmbajtje si më poshtë vijon:



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES

MIRATOHEK
KRYETARI I BASHKISE
ARMANDO SUBASHI

Projektuesi: Ing. Jeton Gjeka
Objekti: Rikonstruksioni i shkolles 9-vjecare "Mark Dashi", Fier

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA
1. PRISHJE				
1	2.426/3	Prishje shtresa betoni	m3	65
2	2.426/1 2	Prishje suvatim solete (h<4m)	m2	710
3	2.426/1 1	Prishje suvatim muri i brendisem	m2	2050
4	2.426/9	Prishje suvatim i jashtem	m2	450
5	2.426	Prishje mur tulle pa pastrim	m3	20
SHUMA 1:				
2. PUNIME DYER DRITARE				
6	2.392	Hegje dritare ekzistuese	m2	310
7	2.391	Hegje dyer ekzistuese	m2	54
8	2.395/a	Dyer d/alumini me mbushje element d/a.	m2	34

9	2.386/2	Dyer te blindaara	m2	12
10	2.375/1	F V dritare d/alumini plastike me dopio xham	m2	310
SHUMA 2:				
3. PUNIME SHITRESASH 2				
11	2.281	Hegje pllaka dyshemeje	m2	1425
12	2.281/5	Hegje pllakash majotike	m2	96
13	2.267/1	Shtrese me pllaka porcelanat	m2	1425
14	2.273/5	Shtrese me pllaka mermeri t=3cm	m2	78
15	2.276	Shtrese parketi	m2	112
16	2.262/4	Shtrese betoni C 16/20	m3	2
SHUMA 3:				
4. PUNIME HIDROIZOLIMI DHE ÇATITE				
17	2.209	Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100	ml	100
18	2.212	Ulluk shkarkimi horizontal me llamarine xingat 33cm	ml	158
19	2.206	Kasete shkarkimi me llamarine xingat	copë	10
20	2.203	Veshje korrnize llamarine xingat	m2	14
21	2.219	Çati vendi e zakonshme me HD-8m,tjegulla marsajseze	m2	572
22	2.197	Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k kstrams	m2	640
23	2.208/1	Hegje ulluk shkarkimi plastik vertikal	ml	100
SHUMA 4:				
5. PUNIME DHEU				
24	2.37/5a	Transport materiale ndertimi, dheu me auto deri 5.0 km	m3	510
25	2.19	Hedhje rrafshim mbushje dheu me krah, kategoria III	m3	30
SHUMA 5:				
6. PUNIME TAVANI DHE SUVATIMI				

26	2.326	Veshje me pllake majolike	m2	96
27	2.324b	Plintuse gres h = 10 cm	ml	630
28	2.324/2	Plintuse mermeri h = 10cm	m2	54
29	2.300/1	Suva solete ~ 4 m, me drejtues, me pompe	m2	710
30	2.310/1	Suva brenda mur tulle ~ 4m, me pompe, li perzier M 25	m2	2050
31	2.328	Patimim muri allci (stuko)	m2	1800
32	2.358/h	Veshje fasade me polisterol t=5cm + rrjete + suva.	m2	1110
33	2.340	Suva xokoli me granit e cimento te bardhe.	m2	114
34	2.331	Suva e rakonshme fasade mur tulle ~ 8m	m2	1110
SHUMA 6:				
7. NENSHTRESA DHE SHITESA NE TERRITORIN E NDERTESAVE				
35	2.423/a	Shtrese avullizoluese gjeotekstil	m2	575
36	2.268/a	Shkalle mermer montazhi	m2	65
37	2.288	Trotuar me pllaka, pa boerduren e betonit	m2	677
38	2.291	Bordura trotuari 25x12cm derdhur ne vend	ml	165
SHUMA 7:				
8. PUNIME BOJATISJE				
39	2.404/1	Boje hidroplastike cilesi e larte	m2	6410
40	2.403	Boje vaji mbi sipërfaqe te patinuar	m2	1000
41	2.421	Pergatitje e vendosje lende e sharruar	m3	3
42	2.400	Boje vaji sipërfaqe druri	m2	180
43	2.410/a	Parapet shkalle e ballkone me tuba inoksi ngjyre e verdhe ose metalizato h = 80 ~ 90 cm	ml	8
44	2.415	F.V porte metalike dekorative rreshqitese	m2	10
45	2.401	Boje vaji sipërfaqe metalik	m2	220
SHUMA 8:				
9. PUNIME TE NDRYSHME				

46	3.643	Mbjellje bari ne skarpet	m2	180
SHUMA 9:				
10. D. SINJALET DHE PAJISJET SHITESE. NGADALESUESIT E SHPEJTESISE				
47	3.961	F.V. Fidane Peme dekorative	copë	14
SHUMA 10:				
11. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE				
48	2.501	F.V. WC allafrenga	copë	27
49	2.215	F.V. Bolier 80 liter, uje te ngrohite	copë	10
SHUMA 11:				
12. ANALIZA JASHTE LISTE				
50	An	F.V. Dyer te Perforcuara Druri	m2	54
SHUMA 12:				
Shuma Analiza				
Fondi Rezervë (5.0%)				
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (5.0%)				
Shuma TVSH (20%)				
Shuma me TVSH				
Totali				



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES

MIRATOHET
KRJETARI I BASHKISE
ARMANDO SUBASHI

Seriali: E42C5B6B-4206-4C4F-80F2-F7A553E9C5E2

Data: 25-08-2025

Objekti: RIKONSTRUKSION I SHKOLLES 9-VJECARE "MARK DASHI", FIER

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMERTIMI I PUNIMEVE	NJESIA	SASIA	CMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1. INSTALIME PER NDRICIM						
1	2.480/5	F.v. Tub plastmasi Ø 31-36mm	ml	1500		
2	2.487	F.v. Katerivacioni plastm	copë	100		
3	2.483	F.v. Çelësa e priza 10 A	copë	57		

4	2.480/2	F.v. Tub plastmasi Ø 18-21mm	ml	100		
SHUMA 1:						
2. ANALIZA JASHITE LISTE						
5	An1	F.v kabell rrjeti FTP cat 6	ml	1750		
6	An2	F.v NVR (network video recorder) 16 chanel	copë	1		
7	An3	F.v kamer IP Dome 5MP (2.8mm;IR40m) indoor	copë	9		
8	An4	F.v kamer IP Bullet 5 MP (2.8mm;IR40m) outdoor	copë	2		
9	An5	F.v UPS 600VA	copë	1		
10	An6	F.v HDD 8TB 24x7 (surveillance hard drive)	copë	1		
11	An7	F.v Switch 24 Porta POE (i menashueshem) (per sistemin e kamerave dhe rrjetin kompjuterik)	copë	3		
12	An8	F.v rack U18	copë	1		
13	An9	F.v Monitor 21.5"	copë	1		
14	An10	F.v krahë per kamerat	copë	2		
15	An11	F.v Patch panel 24 porta (RJ45FTP)cat 6	copë	3		
16	An12	F.v Patch korda 0.5m FTP cat 6A	copë	66		
17	An13	F.v kabell i parafshbrikuar per komunikim central-mikrofon	copë	1		
18	An14	F.v kabell i parafshbrikuar per komunikim central-amplifikator	copë	1		
19	An15	F.v kabell audio FTG 100M1 2x2.5 mm2	ml	200		
20	An16	F.v BOX tavanor inkasues me transformator 100V,tip metalik rezistent ndaj zjarrit,EN 54-24	copë	9		
21	An17	F.v Amplifikator fuqie me shume kanale sipas certifikimit EN 54-16 dhe ne perputhje EN60849,500W me kater zona (sipas sistemit te zgjedhur)	copë	1		
22	An18	F.v njesi qendrore kontrolli central controlling unit (digital int. system manager);EN54-16;dhe ne perputhje EN60849,me 6 zona dhe me mundesi zgjerim,6 hyrje audio,4 dalje audio,me mundesi komunikimi ne rrjet me centralin e zjarrit (sipas sistemit te zgjedhur)	copë	1		

23	An19	F.v mikrofon EN54-16 dhe EN 60049,touch screen dhe me mundesi komandimi 6 zona (sipas sistemit te zgjedhur)	copë	1		
24	An20	F.v modul ushqimi per gjithë elementet e sistemit te lajmerimit: publik zanor dhe audio,se bashku me grupin e baterive i kompletuar me gjithë aksesoret ;EN 54-16 dhe EN 60049	copë	1		
25	An21	F.v panel i alarmit ne raste emergjence me mikrofon per lajmerim publik,EN 5416 dhe EN 60049	copë	1		
26	An22	F.v Tuner/CD player,MP02 me komunikim me centralin e lajmerimit: publik zanor	copë	1		
27	An23	F.v Fajlsje ne fund te ltrjes per kontrollin e linjes se audios EN 54-16 dhe EN 60049	copë	3		
SHUMA 2:						
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (3.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)						
Shuma TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Totali						



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES

MIRATOHEK
KRYETARI I BASHKISE
ARMANDO SUBASHI



Seriali: 21010985-3B68-443A-B398-19818CC3ED58

Objekti: Rikonstruksion i shkollës 9-vjeçare "Mark Dadi", Fier

Data: 25-08-2025

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODE	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
1. INSTALIME PER NDRICIM						
1	2.490/g	F.V. Kasete plastike KE me 48 modular (vend)	copë	7		
2	2.537	F.V. Automat termo-elektrik magnetik 4P:380V/40A	copë	3		
3	2.490/1b	F.V. Automat termo/elektrik, diferencial 2P 220V, 16A	copë	35		

25	2.500	F.V. Perçjellës Tokëzim, Cu, 5-35mm ² , i rrvueshur	m	60		
26	2.496	F.V. Elektroda tokëzim, profil zingëto e bakërisuar, L=1.5m	copë	16		
27	2.503	F.V. Perçjellës shërit Zn 30x3mm	m	300		
28	2.482	F.V. Perçjellës PPV Ø 2x1 mm ²	m	600		
29	2.480/1	F.V. Tsh plastmasi Ø 14-17mm	m	400		
30	2.487	F.V. Kutiderivacioni plastm	copë	51		
31	2.561	F.V. Llampe sinjalizimi 220V/1.2w	copë	6		
32	2.550	F.V. Sirene e brendshme audio vizive	copë	6		
33	2.551	F.V. Sirene e jashtme	copë	2		
SHUMA 1:						
2. GAZE NAFTESJELLES						
34	4.140/7	F.V. Perçjellës Cu te izoluar me gone per ndricim, ne tubot e vendosur me pare, seksion 16mm ²	km	0.54		
SHUMA 2:						
3. PUNIME TE NDRYSHME						
35	3.654/1	F.V. Taba plastmasi ø 80	m	150		
SHUMA 3:						
4. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA						
36	3.176	F.V. Pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086	copë	4		
SHUMA 4:						
5. LINJA T/L GERMIMI I GROPAVE TE SHTYLLAVE						
37	3.497	Germim dhe per gropa shytyllash T/L, ne toke te bute kat I II, ~1.5 m, sip tabore 1.5m ²	m ³	16		
SHUMA 5:						
6. ANALIZA JASHTE LISTE						
38	An1	F.v automat termoelektromagnetik 4P:Id=0.03A;32A/380V	copë	3		
39	An2	F.v automat termoelektromagnetik 4P:52A/380V	copë	3		

40	An3	F.v automat termoelektromagnetik 4P,160A/380V	copë	1	
41	An4	F.v Kabell PG70R 0.6/1 KV,3x1,5mm ² per instalime elektrike	mi	1150	
42	An5	F.v zile elektrike per montim ne shkoila	copë	4	
43	An6	F.v Shkopshes rrjeti per sistemin e MSHA	copë	4	
44	An7	F.v Shizac rrufepritese l = 0.6m;materiali zingato/celik me maje	copë	12	
45	An8	F.v Detektor optik tyni dhe zjarri te adresueshem optik-termik-ionic,automatik temperatura e punes -10°C deri ne 50°C;bateria 1.5V	copë	51	
46	An9	F.v Moxseta per mberthim ne zbritjet e shiritit te sistemit te MSHA	copë	12	
47	An10	F.v Central tyni dhe zjarri i adresueshem,Inteligjent,i programueshem,modul komunikimi me bateri 72 ore pajaresi 230v/12v; 24h autonomi,50 poste pute me nje qark te mbyllur (loop),me aksesore ndihmes (ushqyes i perarcur etj)	copë	1	
SHUMA 6:					
Shuma Analiza					
Fondi Rezervë (3.0%)					
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)					
Shuma TVSH (20%)					
Shuma me TVSH					
Totali					



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA FIER
DREJTORIA E PROJEKTEVE TE INFRASTRUKTURES

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISE
ARMANDO SUBASHI

Data: 19-05-2025

Projektuesi: Ing. Leonora Gjeka

Objekti:RIKONSTRUKSION I SHKOLLES "MARK DASHI", BASHKIA FIER

PREVENTIV PUNIMESH

NR.	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE.	NJËSI A	SASIA	ÇMIMI PA TVSH	VLEFTA PA TVSH
		1. INSTALIME HIDRO-SANITARE DHE NGROHJE				
1	2.510	F.V hidrante Ø 50 mm	copë	3		
2	2.492	F.V tub xingato dhe rakorderi > 1 "	kg	250		
		SHUMA 1:				
		2. TE NDRYSHME, ELEKTRIKE DHE SINJALISTIKA				
3	3.929/ 4	F.v. Pancele plotesuese per sinjale drejtkendore e vogel me Ax/D, 53x18	copë	3		
		SHUMA 2:				
		3. INSTALIME PER NDRICIM				
4	2.550	F.V. Sirene e brendshme audio vizive	copë	3		
		SHUMA 3:				
		4. PAJISJE JASHTË LISTE				
5	Pj	Fikse zjarri 6kg ABC	copë	6		
		SHUMA 4:				
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (0.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (0.0%)						
Shuma TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Shuma Pajisje (pa TVSH në shitje)						
Shuma TVSH (për pajisje)						
Shuma Pajisje (me TVSH në shitje)						
Totali						

III.2.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *“Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;

b) gjendjen ekonomike dhe financiare;

c) aftësinë teknike dhe profesionale.

Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës”.

III.2.5. Neni 39 “Kërkesa të veçanta për kontratat për punë publike”, të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“4. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.2.6. Vendimi i Këshillit të Ministrave Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” në nenin 5 të tij parashikon se: *“Të gjitha institucionet shtetërore, që kryejnë programim të fondeve publike nga buxheti i shtetit apo donatorë të huaj, për efekt planifikimi investimesh për ndërtimin e veprave publike, për të përcaktuar vlerën e fondit limit të veprës orientohen dhe u referohen çmimeve të zërave të punimeve të përcaktuar në sistemin e integruar të manualit të çmimeve të ndërtimit..”.*

Ndërsa në Nenin 6, 7 dhe 18 të tij parashikon :6. *“Hartimi i preventivit apo situacionit, si dhe zbatimi i mbikëqyrjes së çdo punimi ndërtimi, që realizohet nga persona fizikë dhe juridikë, publikë ose privatë, me fonde publike ose private, në territorin e Republikës së Shqipërisë, do të bëhet nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim.”.*

7. *Preventivat për çdo objekt, të hartuara nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve për zërat e punimeve në faqen e preventivave të unifikuar në portalin unik qeveritar e-Albania, sipas metodologjisë së llogaritjes së kostos, janë pjesë e dokumentacionit teknik të çdo objekti të projektuar apo të ndërtuar në Republikën e Shqipërisë.*

18. *Të gjitha detyrimet tatimore ndaj shtetit dhe detyrimet e tjera, të lidhura me veprimtarinë ndërtuese në fushën e ndërtimit, përfshirë sigurimet shëndetësore dhe shoqërore, llogariten sipas vlerave faktike të punimeve, bazuar në analizat teknike të çmimeve, që përfshihen në manualin e çmimeve të ndërtimit, të zbërthyera sipas strukturës së kostos, në përputhje me udhëzimin nr. 2,*

datë 8.5.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos së punimeve të ndërtimit”.

III.2.7. KPP gjykon se kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 *“Për prokurimin publik”*, të ndryshuar. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. KPP gjykon, se autoriteti kontraktor në përputhje me nenin 2 dhe 3 të ligjit 162/2021 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar ka për detyrë d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dhe të garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.

III.2.8. Në rastin konkret, nga verifikimi i preventivit të paraqitur nga ankimuesi, konstatohet se paraqitja dhe plotësimi i zërave të tij është bërë konform përcaktimit të preventivit të publikuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Referuar preventivit të hartuar nga vetë autoriteti kontraktor, KPP konstaton se punimet e kërkuara janë kategorizuar nga ana e autoritetit kontraktor në Punime Ndërtimi dhe montime, si edhe furnizim i pajisjeve me dhe pa TVSH. Komisioni konstaton, se hartimi i strukturës së preventivit për këtë objekt-prokurimi nuk është hartuar nga autoriteti kontraktor konform dispozitave ligjore të fushës së ndërtimit (*Vendim Nr. 216 datë 13.04.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”*, në lidhje me formatin e tabelës përmbledhëse në fund të preventivit.

Tabela përmbledhëse e preventivit ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik nga ana e autoritetit kontraktor është si më poshtë :

23	An19	F.v mikrofon EN54-16 dhe EN 60049,touch screen dhe me mundësi komandimi 6 zona (sipas sistemit të zgjedhur)	copë	1		
24	An20	F.v modul ushqimi për gjithë elementet e sistemit të lajmerimit publik zanor dhe audio,se bashku me grupin e baterive i kompletuar me gjithë aksesoret ;EN 54-16 dhe EN 60849	copë	1		
25	An21	F.v panel i alarmit në raste emergjence me mikrofon për lajmerim publik,EN 5416 dhe EN 60849	copë	1		
26	An22	F.v Tuner/CD player,MP02 me komunikim me centralin e lajmerimit publik zanor	copë	1		
27	An23	F.v Fajlsje në fund të linjes për kontrollin e linjes së audios EN 54-16 dhe EN 60049	copë	3		
SHUMA 2:						
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (3.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)						
Shuma TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Totali						

40	An3	F.v automat termoelektromagnetik 4P;160A/380V	copë	1		
41	An4	F.v Kabell FG70R 0.6/1 kV,3x1,5mm ² për instalime elektrike	m	1150		
42	An5	F.v zile elektrike për montim në shkollë	copë	4		
43	An6	F.v Shkopates rrjeti për sistemin e MSHA	copë	4		
44	An7	F.v Shitëse rrufepritsë l = 0.6m;materiali zingaro/celik me majë	copë	12		
45	An8	F.v Detektor optik tymi dhe zjarri të adresueshem optik-termik-ionic,automatik temperatura e punës -10°C deri në 50°C;bateria 1.5V	copë	51		
46	An9	F.v Morsesta për mbërthim në zëritjet e shiritit të sistemit të MSHA	copë	12		
47	An10	F.v Central tymi dhe zjarri i adresueshem,Inteligjent,i programueshem,modul komunikimi me bateri 72 ore përvarës 230v/12v; 24h autonomi,50 poste pune me një qark të mbyllur (loop),me aksesore ndihmes (ushqyes i paravarur etj)	copë	1		
SHUMA 6:						
Shuma Analiza						
Fondi Rezervë (3.0%)						
Shuma Analiza + Fondi Rezervë (3.0%)						
Shuma TVSH (20%)						
Shuma me TVSH						
Totali						

Ndërsa tabela përmbledhëse e preventivit sipas formatit të preventivit, hartuar në portalin unik qeveritar e-albania, nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të çmimeve është si më poshtë:

DownloadDoc x e-Albania x +

e-albania.al/eAlbaniaServices/MIE/14764/MIE_14764_n4_s2_web.aspx

REPUBLICA E SHQËRIE
MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS
DHE ENERGIKË

Seksioni A: Të dhënat e preventivit

Projektesit: Kodi:

Objekti: Data preventivi: d.d.mmm.vvvv

ZËRAT E PREVENTIVIT

[Zë nga Manuali](#) [Shfaq Analizë jashtë Manualit](#) [Shfaq Pajisje](#)

Nr.	Kodi	Emërtimi	Njësia	Sasia	Çmimi	Vlefia	Veprime
Vlerat përmblledhëse							
		Shuma Analiza				0.00	
		Fondi rezervë 5%				0.00	
		Shuma (Analiza + Fondi Rezervë)				0.00	
		TVSH 20%				0.00	
		Shuma Pajisjet me TVSH				0.00	
		Totali				0.00	

Fondi rezervë [%]: 5

Preventivuesi: Investitori:

68°F Cloudy

Q Search

ENG US

2:42 PM 11/3/2025

Vlerat përmblledhëse

Shuma Analiza	0.00
Fondi rezervë 5%	0.00
Shuma (Analiza + Fondi Rezervë)	0.00
TVSH 20%	0.00
Shuma Pajisjet me TVSH	0.00
Totali	0.00

Parë në rrafshin krahasimor, Komisioni konstaton se, në rastin konkret AK, në strukturën e preventivit të hartuar prej saj dhe ngarkuar në sistemin e prokurimit elektronik, me atë të hartuar nëpërmjet sistemit të integruar të manualit të cmimeve, ka përcaktuar Furnizim+Vendosje (F. V) dhe i ka llogaritur fondë rezervë (3%) pajisjeve. Në dokumentet standarde të tenderit, është e përcaktuar në seksionin I, Udhëzime për operatorët ekonomikë, gërma B. PËRGATITJA E OFERTAVE, pika 4. “Formularët e tenderit dhe preventivat e Çmimeve: *Operatori Ekonomik paraqet Formularin e Ofertës në përputhje me formularin e paraqitur në Seksionin II: Të gjithë Formularët shoqërues duhet të plotësohen pa ndonjë ndryshim, nuk do të pranohet asnjë zëvendësues. Të gjitha vendet bosh duhet të plotësohen me informacionin e kërkuar [...]*”. Konstatohet se, preventivi i paraqitur nga ana e operatorit ekonomik ankimes është në përputhje me të gjithë zërat e kërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

III.2.9. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, në të cilin parashikohet shprehimisht se: *2.Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose*

vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji ku thuhet shprehimisht: “Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...]”, gjykon se hartimi i strukturës së preventivit jo në përputhje me aktet ligjore/nënligjore në fuqi të legjislacionit të posaçëm të ndërtimit përbën shkak për anulimin e kësaj procedure prokurimi. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor duhet të anulojë procedurën e prokurimit objekt-ankimi dhe në rishpalljen e saj të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mbyllë çështjen për pjesën e pranuar, për operatorin ekonomik “Shendelli” SHPK, për procedurën e prokurimit “E hapur”, me Nr. REF-60127-09-02-2025, me objekt “Rikonstruksion i Shkollës “Mark Dashi”, Bashkia Fier” me fond limit 50 661 598.12 (pesëdhjetë milion e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e një mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e tetë pikë dymbëdhjetë) lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Fier.
2. Të pranojë pjesërisht ankesën e operatorit ekonomik “Shendelli” SHPK në procedurën e prokurimit objekt ankimi.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
5. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Shendelli” SHPK.

6. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
7. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Gjergj Mersini

Anëtar
Anila Malaj

Nënkryetar
Fiorent Zguro

